



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME FIER SH.A**

Nr. \_\_\_\_\_ prot

Fier, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**“Blerje Materiale Hidraulike”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Materiale hidraulike 44115210-4

Tuba dhe përshtatës 44163000-0

Tuba kanalizimesh 44163130-0

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**15,687,185** (pesëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), Autoriteti/enti Kontraktor “Shoqëria Rajonale e Ujësjellës-Kanalizime Fier”Sh.A, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1. Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:**

Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 8 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

**2.1.1** Të jetë qartësisht e specifikuar në QKB, se objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik është i njëjtë ose “ekuivalent” me objektin e prokurimit.

## ➤ **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare **(2021-2022-2023), ku vlera e xhiros, per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës (vlera e fondit limit).**

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori Ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

***Argumentimi:*** Kërkesa e mësipërme është bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar nënenin 77 pika 3 i LPP, si dhenenin 43 pika 2, gërma “b” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përcaktimi i vlerës dhe i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore, argumentohet si vijon: Vendosija e këtij kriteri kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues, i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

---

**2.2.2** Kopje të vërtetuar të bilanceve për vitet **(2022-2023)** të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të konfirmuar nga administrata tatimore.

***Argumentimi:*** Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 43, pika 4 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe i shërben AK që të vërtetojë se OE fitues disponon të gjithë kapacitetin e duhur financiar për të realizuar kontratën.

---

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2024 (kestet e maturuara)**, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

***Argumentimi:*** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, nën 3.1/a, b, c dhe nën 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

## **2.3 AFTËSITË TEKNIKE DHE PROFESIONALE:**

**2.3.1** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit (2021-2022-2023) nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vlera totale e të cilave duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet**, të realizuar gjatë ketyre tre viteve.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Arsyetimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 1/gërma“c” të Ligjit nr.162, dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 40 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

**2.3.2** OE ofertues duhet të paraqesë **Autorizim Prodhuesi** ose **distributori zyrtar** për mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje të autorizimit nga distributori i autorizuar, operatori ekonomik duhet të provojë me dokument, lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**Arsyetimi:** Kërkesa e mësipërme pika 2.3.4 është vendosur sipas nenit 40 pika 3, neni 44 pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe në nenin 36 pika 3/b) të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”. Ky kriter është vendosur ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë me objektin e prokurimit.

**2.3.3** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë çertifikatë **DVGW / WRASN** ose **ekuivalente**, të aprovimit për përdorimin e ujit të pijshëm për të gjithë mallrat që kanë kontakt me ujin e pijshëm, të lëshuar nga një trup i çertifikuar ndërkombëtar apo kombëtar i akredituar.

Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

**Arsyetimi:** Bazuar në nenet 40 pika 3 dhe 44 pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo Çertifikatë ose ekuivalente e saj, kërkohet për t’u siguruar që materialet e përdorura të kenë standartet e duhura të cilësisë, pasi janë në kontakt me ujin e pijshëm i cili duhet të jetë i pastër dhe me parametrat e duhur higjeno-sanitar.

**2.3.4** Operatorët Ekonomik në momentin e hapjes së ofertave, duhet të paraqesin nga **një mostër** për artikujt/zërat si më poshtë:

Nr	Përshkrimi materialit	Njësia
1	BRRYLA FI 20X3/4" Mashkull 16Atm	copë
2	MANIKOTA ME ELEKTROFUZION DN125 16Atm	copë
3	REKORDE HDPE 20X1/2" 16ATM Mashkull 16Atm	copë
4	REKORDE HDPE 25X3/4" 16ATM mashkull 16Atm	copë
5	FASHETA INOKSI QORRE FI 84-105	copë

6	FASHETA INOKSI ME DALJE TE FLLANXHUAR (240-260) X 100 L=300mm	copë
7	TAPA FUNDOR ME NGJITJE DN 250 16Atm	copë
9	TI HDPE DN 63X40X63 16Atm	copë
10	BASHKUES PP FI 110 16 ATM	ml
11	TUBO PEHD FI 25 10 ATM	ml
12	TUBO PEHD FI 40 10 ATM	ml
13	TUBO PEHD FI 63 10 ATM	copë
14	TUBO PEHD FI 20 16 ATM	copë
15	TUBO PEHD FI 32 16 ATM	copë
16	TUBO PEHD FI 50 16 ATM	copë
17	TUBO PEHD FI 63 16 ATM	copë
18	SARACINESKA 6" (PER DEPOZITE)	copë
19	REDUKTOR PRESJONI DN 125	copë
20	BASHKUES I TEJDUKSHEM PP ME SITE DN32	copë
21	BASHKUES GIZE ME SISTEM SHTRENGIMI ME KAPESE DN 198-228 16Atm	copë
22	FASHETE EF ME SHPIM NE PRANI TE UJIT 75*25 16 Atm	copë
23	FASHETE EF ME SHPIM NE PRANI TE UJIT 75*20 16 Atm	copë
24	FASHETE EF PE100 DE 40 X 32 16 ATM	copë
25	FASHETE EF PE100 DE 40 X 40 16 ATM	copë
26	FASHETE EF PE100 DE160X40 16 ATM	copë
27	FASHETE EF PE100 DE160X 50 16 ATM	copë
28	TEE HDPE ME NGJITJE DN 160 mm Atm 16	copë
29	TEE HDPE ME NGJITJE DN 40 mm Atm 16	copë
30	REDUKSION EF 16 Atm 32X20	copë

Dorëzimi i mostrave, të bëhet pranë Drejtorisë Teknike, të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës-Kanalizime Fier Sh.A, të mbyllura në një kuti jo transparente, të vulosur mbi të cilin të shënohet:  
*“Mos e hapni, me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit “Blerje Materiale Hidraulike”.*

**Data e dorëzimit të mostrave të jetë data e hapjes së ofertave data \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024, deri në orën 10:00.** Mostrat e dorëzuara jashtë këtij afati, nuk do të pranohen nga AK.

- *Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në kuti.*
- *Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënojë nr.rendor të Artikullit që përfaqëson.*  
Mos-dorëzimi i mostrave në momentin e hapjes së ofertave ose mospërputhja e mallrave të ofruara me mostrat e paraqitura, është kusht për skualifikim. Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr.Rendor, nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet.

**Arsyetimi:** Bazuar në nenin 40 pika 6/gërma(a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; Udhëzimin nr.3 datë 12.04.2022 “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomik”. Ky kriter vendoset me qëllim që Autoriteti Kontraktor të verifikojë nëse mallrat e ofertuara i plotësojnë specifikimet teknike në DST dhe janë brenda standarteve të kërkuara.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Katalogun e prodhuesit** të mallrave, ku të vërtetohet përputhjen e plotë të mallrave që ofron me specifikimet teknike të kërkuara.

Katalogu duhet të ketë të detajuar specifikimet teknike të mallrave që do të ofrohen, ku të vërtetohet që mallrat e ofruar, plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara. **Pjesët e katalogut ku tregohen specifikimet teknike, të jenë të përkthyer në shqip dhe të noterizuara.**

**Arsyetimi:** Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me pikën 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**2.3.6** Ofertuesi duhet të paraqesë dokumentin e titulluar **Ofertë Teknike** i paraqitur nga AK në formën e një table (pjesë e dokumentacionit të specifikimeve teknike), kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi për të gjithë listën e artikujve që kërkohen. Dokumenti Oferte Teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

Nr.i produktit	Emërtimi i produktit	Emri i kompanisë prodhuese	Emri i katalogut	KODI i produktit ose nr.i Faqes në katalog ose dok. e noterizuar	Shënim sqarues

**Arsyetimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 36 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 40 pika 2 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Qëllimi i vendosjes të kriterit të sipërcituar ka të bëjë me faktin e orientimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në fazën e ofertimit të dokumentacionit teknik të paraqitur nga operatorët pjesëmarrës.

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të dorëzojë një **Deklaratë që merr përsipër transportin** dhe lëvrimin e mallrave drejt ambjenteve magazinuese të Autoritetit Kontraktor.

**Arsyetimi:** Autoriteti Kontraktor në formulimin e kriterit për kapacitetin transportues të mallrave, i qëndron rigorozisht faktit se OE i cili do të shpallet fitues, duhet të kryejë edhe transportin në destinacion të mallrave objekt prokurimi, për nevojat e AK, i cili nuk do të paguaj shpenzime shtesë për këtë shërbim.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

#### ➤ SPECIFIKIME TEKNIKE

##### • **Rakorderite me kompresion**

Rakorderite shërbejnë për bashkimin dhe pershtatjen e tubave ose rakorderive plastike me permasa të ndryshme. Trupi i rakorderive të jete material Polipropilen me rezistencë mekanike të lartë. Produktet duhet të jenë të bombarduara me rreze ultraviolette në mënyrë që mos të krijojnë alga ose baktere. Gjithashtu këto rakorderi nuk duhet në asnjë mënyrë të krijojnë mikroorganizma në ujë të pijshëm. Sipërfaqja e brendshme e produkteve duhet të jete homogjene dhe nuk duhet të jete poroze. Produktet nuk duhet të përmbajne asnjë tip substancë që ndryshojnë shijen ose erën e ujit. Presioni I punës të jete 16 bar (ose më i lartë) bazuar në standartin ISO 1167-1 dhe ISO 1167-4 (ose ekuivalentet e tyre). Metoda e testimit për të kontrolluar nëse ka rrjedhje pas shtrengimit të rakorderive në tubin plastik duhet të jete sipas ISO 3458 ose ekuivalent. Rezistenca mekanike e shtrengimit të rakorderive kundrejt tërheqjes së tubit duhet të jete testuar sipas standartit ISO 3501 ose ekuivalent me të. Rakorderite duhet të jenë konform ISO 17885 dhe ISO 3503 (ose ekuivalente të tyre). Filetimi I tyre të jete sipas standartit ISO 7-1 ose ekuivalent. Ndryshimi në dimensionet e produkteve të jete maksimumi  $\pm 0.5$  mm nga dimensionet e kerkuara nga AK.

##### • **Fasheta Inoksi Qorre**

Fashetat riparuese të jenë inoks (AISI 304 sipas standartit EN 1.4301) ose ekuivalent. Gomina të jete e ngjitur me fasheten e inoksit me ngjites të perforcuar me fibra xhami për të pasur jetegjatesi dhe qëndrueshmeri ndaj temperaturave të larta dhe lageshtise gjatë montimit. Fashetat e inoksit të jenë të certifikuar nga institucione nderkombetare për përdorim në ujë të pijshëm dhe të jenë të pajisura me certifikata të tipit ACS, WRAS, BS ose ekuivalente. Pjesa e gomuar e fashetes të jete gome EPDM, NBR ose ekuivalente të këtyre materialeve. Goma e përdorur në fasheten e inoksit duhet të jete çilesi shumë e lartë sepse ka kontakt të drejtperdrejt me ujin e pijshëm prandaj ajo duhet të jete për përdorim për ujë të pijshëm.

##### • **Fasheta Inoksi me dalje të fllanxhuar**

Fashetat riparuese të jenë inoks (AISI 304 sipas standartit EN 1.4301) ose ekuivalent. Fashetat duhet të jenë me dalje me fllanxhe. Gomina të jete e ngjitur me fasheten e inoksit me ngjites të

perforcuar me fibra xhami për të pasur jetegjatesi dhe qëndrueshmeri ndaj temperaturave të larta dhe lageshtise gjatë montimit. Fashetat e inoksit të jenë të certifikuar nga institucione nderkombetare për përdorim në ujë të pijshëm dhe të jenë të pajisura me certifikata të tipit ACS, WRAS, BS ose ekuivalente. Pjesa e gomuar e fashetes të jete gome EPDM, NBR ose ekuivalente të këtyre materialeve. Goma e përdorur në fasheten e inoksit duhet të jete çilesi shumë e lartë sepse ka kontakt të drejtperdrejt me ujin e pijshëm prandaj ajo duhet të jete për përdorim për ujë të pijshëm

- **Rakorderite me elektrofuzion dhe me ngjitje PN16**

Rakorderite elektrofuzive dhe rakorderite me ngjitje duhet të jenë të prodhuara me plastik HDPE 100 te paster dhe jo plastike tericlikuar, për tu përdorur në linjat e furnizimit me ujë të pijshëm. Ato duhet të ketë të shënuara në trup gjithë të dhënat për saldimin. Densiteti i materialit PE ne keto manikota EF dhe ne keto rakorderi PE te jete minimumi 0.95g/cm<sup>3</sup>. Elektromanikotat dhe rakorderite PE duhet te jene ne perputhje me standartin ISO 4427 ose ekuivalent me te. Moduli i terheqjes se materialit HDPE te jete testuar dhe me pas gjetur te jene ne perputhje me standartin ISO 527-2 ose ekuivalent me te.

Po ashtu sforcimi i terheqjes deri ne keputje te materialit hdpe te ketyre manikotave EF dhe rakorderive PE, te jete testuar dhe gjetur te jete ne perputhje me standartin ISO 527-2 ose ekuivalent me te. Ky material duhet te jete i afte te duroje deri ne 25 Mpa para se te keputet. Permbajtja e te zezes ne karbonin e ketyre elektromanikotave dhe rakorderive PE mos te jete me pak se 2% dhe ky faktor te jete testuar dhe gjetur te jete ne perputhje me standartin ASTM D 1603. Koha e induksionit te oksidimit te manikotave EF dhe rakorderive PE ne 210oC mos te jete me pak se 20 minuta dhe kjo te jete testuar dhe gjetur te jete ne perputhje me standartin EN 728 ose ekuivalent me te. Keto elektromanikota dhe rakorderi PE duhet te jene te forta dhe rezistente ndaj plasaritjeve por nese plasaritja ndodh atehere ato duhet gjithashtu te jene rezistente ne menyre qe keto plasaritje mos te hapen me tej dhe kjo te jete ne perputhje me standartin ISO 13477 dhe ISO 13479 ose ekuivalente me to. Duhet te jene te certifikuar per perdorim ne uje te pijshem dhe te shoqerohen me certifikatat perkatese. Per te treguar perputhshmerine me standartet e permendura me siper, pranohen dhe permendja e ketyre standarteve ne kataloget qe do te ofrohen per elektromanikotat dhe rakorderite PE te kerkuara.

- **TUBOT HDPE**

Tuba polietileni me dendësitëlartë. Tejenesipasstandartit EN 12201 oseekuivalent me te. Tubat tëkenënjëkoeficientsigurimiminimalisht 1.20. Materialet e përdorurapërprodhimin e tubavetëjene jo toksikedhetëmosndikojnëncilësinë e ujit (most'I japinatij as erë as shije). Tëjenëfleksibëldhe me rezistencëndajvibrimevedhegoditjevesizmike, për'tupërshtatur me relievin e tokës.Të jenë rezistent ndaj rrezeve ultraviolet dhe ndaj temperaturave -25 derinë 55°C.Të kenë rezistencë të lartë ndaj gërryerjes dhe jetegjatesi te pakten 50 vjet.Pamja e jashtme: të kenë siperfaqe të lëmuar dhe pa dëmtime, prerja fundore e tubit duhet të jetë e pastër dhe në kënd të drejtë me qëndrën e tubit.Produktet duhet të kenë certifikate aprovimi nga të paktën 1(një) institucion ndërkombëtar ose kombëtar për përdorimin për ujë të pijshëm (p.sh DVGW).Permasatdhepresionet e punes se tuboveperkatesishtsipaspreventivit

- **BASHKUES I TEJDUKSHEM PP ME SITE DN32**

Bashkuesi duhet te jete material polipropilen me shtrengim nga te dy krahet. Trupi I bashkuesit duhet te jete I tejdukshem ne menyre te dallohet uji kur kalon ne te. Bashkuesi brenda trupit te tij duhet te kete nje site, per te permiresuar cilesine e ujit.Bashkuesi duhet te jete I certifikuar per perdorim ne uje te pijshem, si pasoje e kontaktit te drejtperdrejt me te.. Presioni I punes se ketyre bashkuesve te jete minimumi 10 bar.

- **Bashkues Gize me sistem shtrengimi me kapese**

Bashkuesi i gizes me kapese shërben për të bashkuar ose lidhur me tub PE, PVC, gize, etj ndërmjet tyre, dhe duhet të ofrojë garanci dhe siguri në bashkimin e tubave me anë të elementëve të ndryshëm shtesë që shërbejnë për mbërthimin dhe shtrengimin e tubave. Toleranca midis dy anëve të bashkimit të tubave duhet te jete minimumi prej 8 gradësh. Bashkuesit duhet te jene te pajisur me gome EPDM për përdorim uje të pishëm sipas standartit EN 681-1 (ose ekuivalent). Kapset e bashkuesit duhet të jenë material POM, të dhëmbëzuara të cilat duhet të jenë material prej çeliku sipas DIN 1.1132 (ose ekuivalent) dhe DIN 1654 (ose ekuivalent me të), që sigurojnë një lidhje të qëndrueshme të tubit me bashkuesin.. Trupi i

bashkuesit dhe kapeset shtrënguese duhet të jenë material gize EN-GJS-500 sipas standartit EN 1563 (ose ekuivalent). Veshja e bashkuesit duhet të jetë me bojë epokside që lejohet për ujë të pijshëm me trashësi lysterje minimumi 250µm sipas standartit DIN 30677 (ose ekuivalent). Bashkuesi duhet të jetë i testuar sipas standartit EN 14525 dhe EN 545 (ose ekuivalente) dhe të ketë presion pune 16 bar ose më të lartë. Bulonat dhe rondelet duhet të jenë material inoks A2 sipas standartit EN 10088-1(ose ekuivalent) ndërsa dado duhet të jetë material inoks A4 sipas standartit EN 10088-1(ose ekuivalent).

- **Manikote EF HDPE100 PN25**

Manikotat EF HDPE100 PN25 duhet të ketë të shënuara në trup gjithë të dhënat për saldimin. Ato duhet të jenë të prodhuara me plastike HDPE 100 te paster dhe jo plastike te riclikuar, për tu përdorur në linjat e furnizimit me ujë të pijshëm. Tensioni I punes të jetë minimumi 47V. Manikotat EF HDPE100 PN25 duhet të jenë të pajisura me një tregues për ngjitjen, këto tregues duhet të jenë të vendosura afër me konektorët dhe të jenë te sigurta qe te mos kete rrjedhje te materialit ngjites. Produktet duhet te jene te markuara ne trup me marken CE ose ekuivalent dhe shenjimi i tyre te jete sipas standartit EN 1555-3 ose ekuivalent me te. Manikotat EF HDPE100 PN25 duhet te jete konform me standardin EN 12201-3:2001 ose ekuivalentin e tij, edhe sipas standartit ISO 4427-1 ose ekuivalentit te tij. Toleranca ne diameter dhe trashesi per keto produkte te mos jete me shume se  $\pm 5\%$ . Forca hidrostatike e ketyre manikotave EF HDPE100 PN25 te jete testuar sipas standartit EN ISO 1167-1 ose ekuivalentit e ketij te fundit.

Produktet duhet të kenë certifikate aprovimi nga të paktën 1(një) institucion ndërkombëtar për përdorimin për ujë të pijshëm (p.sh WRAS etj). Permasate manikotave EF HDPE100 PN25 te jenë të përshtatshme për tu salduar nga një makineri saldimi dhe kontrolli i ketyre permasave te jete testuar sipas standartit EN ISO 3126 ose ekuivalent.

Lënda e parë që do te përdoret për prodhimin e ketyre rakorderive duhet të jetë e një cilësie tepër të lartë dhe matja e rrjedhjes se shkrirjes se kesaj plastike duhet te jete konform me standardin EN ISO 1133-1 ose ekuivalent me te.

- **Paste Linacoje 0.5 Kg**

Paste linacoje ose ndryshe paste filetash hidraulike te jete e pershtatshme per punime hidraulike, te jete me dendesi 0,9-0,95 g/cm<sup>3</sup> sipas standartit ASTM D1298 (ose ekuivalent), e patretshme ne uje dhe jo gerryese. Pika e ndezjes te jete me e larte se 230 C, dhe kjo te jete testuar sipas standartit ASTM D 92 (ose ekuivalent).

- **Saracineske 6" (per depozite)**

Saracineska e depozites duhet te jete gize sipas standartit EN-GJS-500-7 dhe e lyster me boje epokside me nje trashesi prej minimum 250µm. Saracineska vendoset ne fund te depozites dhe ben te mundur kalimin ose jo te ujit nepermjet hapjes ose mbylljes se saj me volant. Temperatura e punes se ketyre saracineskave te jete nga 0 deri ne 60°C (do te pranohen temperatura pune dhe me te larta).

Veshja epokside duhet te jete vendosur ne saracineska me pjekje ose me shkrirje sipas standartit EN 14901 ose ekuivalent me te. Saracineskat duhet te jene te pajisura me pengues qe kontrollohet nga volanti dhe qe bent e mundur kalimin e ujit ose jo, dhe keta pengues duhet te jene material elastomer EPDM ne perputhje me standartin EN681-1 ose ekuivalent me te, e certifikuar per uje te pijshem.

Volanti I saracineskes duhet te jete ne perputhje me standartet EN 10111 dhe EN 10130 ose ekuivalent me to. Bulonat, dadot dhe rondelet e saracineskave te jene prej celiku te veshur me zinc dhe te jene sipas standartit ISO 898-2 ose ekuivalent me te.

**Për të gjithë standartet e sipërpërmendura, do të pranohen dhe ekuivalentet e tyre të huaja dhe shqiptare.**



• **Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasi të e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr.162, date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

➤ **Sasia e mallit që kërkohet:**

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	BRRYLA FI 20X3/4" Mashkull 16Atm	Copë	300
2	BRRYLA PEHD 20 X1/2" MASHKULL 16Atm	Copë	300
3	BRRYLA REKORD PEHD 25x1/2" mashkull 16Atm	Copë	300
4	BRRYLA REKORD PEHD 25X3/4" mashkull 16Atm	Copë	300
5	FASHETA INOKSI 93-119	Copë	10
6	FASHETA INOKSI QORRE FI 84-105	Copë	20
7	FASHETA INOKSI QPRRE FI 133-157	Copë	10
8	FASHETA INOKSI QORRE FI 190-221	Copë	10
9	FASHETA INOKSI QORRE 218-242	Copë	5
10	FASHETA INOKSI QORRE 440-460 L=400mm	Copë	2
11	FASHETA INOKSI ME DALJE TE FLLANXHUAR (240-260) X 100 L=300mm	Copë	2
12	MANIKOTA ME ELEKTROFUZION DN125 16Atm	Copë	20
13	MANIKOTA ME ELEKTROFUZION DN 160 16Atm	Copë	20
14	MANIKOTA ME ELEKTROFUZION DN 110 16Atm	Copë	20
15	MANIKOTA ME ELEKTROFUZION DN 160 25Atm	Copë	2
16	BERRYL EF 45°C DN315 16Atm	Copë	2
17	TAPA FUNDOR ME NGJITJE DN 250 16Atm	Copë	2
18	REKORDE HDPE 20X3/4" 16ATM mashkull 16Atm	Copë	200
19	REKORDE HDPE 20X1/2" 16ATM Mashkull 16Atm	Copë	200
20	REKORDE HDPE 25X3/4" 16ATM mashkull 16Atm	Copë	200

21	REKORDEHDPE 25X1/2" 16ATM mashkull 16Atm	Copë	200
22	TI HDPE DN 63X40X63 16Atm	Copë	10
23	TI HDPE DN 63X50X63 16Atm	Copë	10
24	TI F HDPE DN 90X63X90 16Atm	Copë	10
25	BASHKUES HDPE FI 20 16 ATM	Copë	300
26	BASHKUES HDPE FI 25 16 ATM	Copë	300
27	BASHKUES HDPE FI 50 16 ATM	Copë	100
28	BASHKUES PP FI 110 16 ATM	Copë	20
29	TUBO PEHD FI 20 10 ATM	ML	4,000
30	TUBO PEHD FI 25 10 ATM	ML	4,000
31	TUBO PEHD FI 32 10 ATM	ML	4,000
32	TUBO PEHD FI 40 10 ATM	ML	4,000
33	TUBO PEHD FI 50 10 ATM	ML	3,000
34	TUBO PEHD FI 63 10 ATM	ML	3,000
35	TUBO PEHD FI 75 10 ATM	ML	1,000
36	TUBO PEHD FI 20 16 ATM	ML	3,000
37	TUBO PEHD FI 25 16 ATM	ML	4,000
38	TUBO PEHD FI 32 16 ATM	ML	4,000
39	TUBO PEHD FI 40 16 ATM	ML	4,000
40	TUBO PEHD FI 50 16 ATM	ML	3,000
41	TUBO PEHD FI 63 16 ATM	ML	2,000
42	TUBO PEHD FI 75 16 ATM	ML	1,000
43	SARACINESKA 6" (PER DEPOZITE)	Copë	2
44	REDUKTOR PRESJONI DN 250	Copë	2
45	REDUKTOR PRESJONI DN 125	Copë	2
46	REDUKTOR PRESJONI DN 90	Copë	2
47	BASHKUES I TEJDUKSHEM PP ME SITE DN32	Copë	2
48	PASTE LINACOJE 0.5 KG	Copë	10
49	BASHKUES GIZE ME SISTEM SHTRERNGIMI ME KAPESE DN	Copë	2

	198-228 16Atm		
50	FASHETE EF ME SHPIM NE PRANI TE UJIT 75*25 16 Atm	Copë	5
51	FASHETE EF ME SHPIM NE PRANI TE UJIT 75*20 16 Atm	Copë	5
52	FASHETE EF ME SHPIM NE PRANI TE UJIT 63*25 16 Atm	Copë	5
53	FASHETE EF ME SHPIM NE PRANI TE UJIT 63*20 16 Atm	Copë	10
54	FASHETE EF PE100 DE 40 X 32 16 ATM	Copë	100
55	FASHETE EF PE100 DE 40 X 40 16 ATM	Copë	10
56	FASHETE EF PE100 DE50 X 40 16 ATM	Copë	13
57	FASHETE EF PE100 DE63 X 40 16 ATM	Copë	11
58	FASHETE EF PE100 DE63 X 50 16 ATM	Copë	10
59	FASHETE EF PE100 DE63 X 63 16 ATM	Copë	5
60	FASHETE EF PE100 DE75 X 40 16 ATM	Copë	15
61	FASHETE EF PE100 DE75 X 50 16 ATM	Copë	10
62	FASHETE EF PE100 DE75 X 63 16 ATM	Copë	5
63	FASHETE EF PE100 DE90 X 40 16 ATM	Copë	10
64	FASHETE EF PE100 DE90 X 50 16 ATM	Copë	10
65	FASHETE EF PE100 DE90 X 63 16 ATM	Copë	5
66	FASHETE EF PE100 DE90 X 90 16 ATM	Copë	4
67	FASHETE EF PE100 DE110 X 40 16 ATM	Copë	5
68	FASHETE EF PE100 DE110 X 50 16 ATM	Copë	5
69	FASHETE EF PE100 DE110x63 16 ATM	Copë	5
70	FASHETE EF PE100 DE110x75 16 ATM	Copë	4
71	FASHETE EF PE100 DE110x90 16 ATM	Copë	4
72	FASHETE EF PE100 DE125x40 16 ATM	Copë	5
73	FASHETE EF PE100 DE125 X 50 16 ATM	Copë	4
74	FASHETE EF PE100 DE125X63 16 ATM	Copë	4
75	FASHETE EF PE100 DE125X75 16 ATM	Copë	4
76	FASHETE EF PE100 DE125X90 16 ATM	Copë	4
77	FASHETE EF PE100 DE125X110 16 ATM	Copë	4

78	FASHETE EF PE100 DE140X 40 16 ATM	Copë	5
79	FASHETE EF PE100 DE140X 50 16 ATM	Copë	4
80	FASHETE EF PE100 DE140X75 16 ATM	Copë	4
81	FASHETE EF PE100 DE140X90 16 ATM	Copë	14
82	FASHETE EF PE100 DE160X40 16 ATM	Copë	7
83	FASHETE EF PE100 DE160X 50 16 ATM	Copë	4
84	FASHETE EF PE100 DE160X 63 16 ATM	Copë	4
85	FASHETE EF PE100 DE160X 75 16 ATM	Copë	4
86	TEE HDPE ME NGJITJE DN 160 mm Atm 16	Copë	9
87	TEE HDPE ME NGJITJE DN 140 mm Atm 16	Copë	19
88	TEE HDPE ME NGJITJE DN 125 mm Atm 16	Copë	8
89	TEE HDPE ME NGJITJE DN 110 mm Atm 16	Copë	12
90	TEE HDPE ME NGJITJE DN 90 mm Atm 16	Copë	11
91	TEE HDPE ME NGJITJE DN 40 mm Atm 16	Copë	61
92	TEE HDPE ME NGJITJE DN 32 mm Atm 16	Copë	61
93	REDUKSION EF 16 Atm 32X20	Copë	80

• **GRAFIKU I LËVRIMIT**

Afatet e lëvrimit: **3 muaj nga momenti i nënshkrimit të Kontratës.**

<b>Muaji</b>	<b>Kërkesa</b>
<b>Muaji I</b>	Dorëzimi i 40% të sasisë të materialeve të kërkuara, duke u bazuar te preventivi i paraqitur. Të rëndësishme janë tubat $\phi 20$ , $\phi 25$ , $\phi 32$ , $\phi 40$ , $\phi 50$ , $\phi 63$ , rekorderitë, fashetat përkatëse të këtyre tubave.
<b>Muaji II</b>	Dorëzimi i 30% të sasisë të materialeve të kërkuara, duke u bazuar te preventivi i paraqitur, sipas kerkesave te Autoritetit Kontraktor <i>në varësi të situatave, emergjencave dhe nevojave të punës.</i>
<b>Muaji III</b>	Dorëzimi i 30% të sasisë të zërave të kërkuar, duke u bazuar te preventivi i paraqitur.

***NJËSIA E PROKURIMIT***

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_